

URDHËR
Nr.4/1, datë 15.4.2011

**PËR KRITERET DHE PROCEDUAT E KRYERJES SË RIMBURSIMIT TË PAGESËS
PËR PAJISJET FISKALE DHE TAKSIMETRAT E SUBJEKTEVE TË BIZNESIT TË
VOGËL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, Ministri i Financave

URDHËRON:

1. Pika 7 e urdhrit nr.4, datë 12.1.2011 “Për kriteret dhe proceduat e kryerjes së rimbursimit të njërive të qeverisjes vendore, të pagesës për pajisjet fiskale dhe taksimetrat”, shfuqizohet dhe bëhet:

“Transferimi i fondeve do të kryhet te llogaria buxhetore: Entiteti i Qeverisjes 001”, Ministria 10, njësia shpenzuese 1010001, kapitulli 01, program 01130 (ekzekutimi i pagesave të ndryshme), artikulli 603.3 me emërtimin “Rimbursim për subjektet e biznesit të vogël për vlerën e pajisjeve fiskale”, Kodi i Degës së Thesarit 3535.”.

2. Pika 8 e po këtij urdhri shfuqizohet dhe bëhet:

“Me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për akordimin e fondeve për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, që ka shkuar për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit kryen çeljen sipas pikës 7.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit realizon në sistem kalimin e veprimit në qendër, sipas procedurës së transaksioneve me xhirim të brendshëm (pa lëvizje *cash*), në kategorinë “Xhirime brenda institucionit”, vlerën përkatëse të çdo njësie të qeverisjes vendore në artikullin 7002100 (taksa e biznesit të vogël)”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode